



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 9 MARS 2020**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 09. MARTA 2020. GODINE**

**MARS - MART
2020**

Rendi i ditës

1. Seancë për Ditën Ndërkombëtare të Gruas, kushtuar sensibilizimit të çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Dnevni red

1. Sednica povodom Međunarodnog dana žene, posvećena senzibilizaciji pitanja žrtava seksualnog nasilja u toku poslednjeg rata na Kosovu.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara, zoti Filip Kosnet,

E nderuar përfaqësuese e Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës, zonja Natalija Apostolova,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike në Republikën e Kosovës,

Të nderuara përfaqësuese të shoqatave të grave,

Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj të pranishëm,

E nderuara zonja Vafije Krasniqi-Goodman,

Të nderuar të gjithë ju të pranishëm,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mirë se keni ardhur në seancën e veçantë të Kuvendit të Republikës për Ditën Ndërkombëtare të Gruas kushtuar sensibilizimit të çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

E ftoj kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu, që ta marrë fjalën me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas kushtuar sensibilizimit të çështjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë

Zonja Osmani, fjala për ju!

KRYETARJA E KUVENDIT, VJOSA OSMANI: Shumë e nderuar heroinë e jona, znj. Vafije Krasniqi-Goodman,

E nderuar familje Krasniqi,

I nderuar kryeministër Kurti,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar shkëlqesi ambasadorë,

Të nderuara përfaqësuese të organizatave joqeveritare që vazhdimisht keni mbështetur gratë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Monumenti i pavarësisë “Newborn”, krahas krenarisë, çdo vit na e shpalos nga një faqe të brengës sonë të përbashkët. Sivjet ky monument na e shpërfaqti dhimbjen tonë më të madhe: zërin e heshtur të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës. Dhjetëra histori të trishta njerëzore, të kthyer në dhjetëra mesazhe, na e rikujtuan edhe një herë plagën tonë të madhe, dhunën e përjetuar gjatë luftës në Kosovë, por edhe gabimin tonë të pafalshëm karshi historisë

sonë: heshtjen e zërit të të mbijetuarave të kësaj dhune për shkak të mosveprimit të drejtësisë, për shkak paragjytimeve, stigmave e mosbesimit.

Porse të mos e rrëfesh krimin, të mos lejosh të rrëfëhet ai krim, të mos e vendosësh drejtësinë në vend është sikur ta mohosh rishtas atë; ta heshtësh zërin e viktimave është njësoj sikur t'i përdhunosh për së dyti herë; të mos e përkrahësh lirinë e tyre për ta dëshmuar krimin e për ta kërkuar drejtësinë është sikur ta mbytësh zërin e viktimës e ta bësh viktimë tërë shoqërinë.

E grave të Kosovës, ndaj të cilave është ushtruar dhunë e egër nga aparati shtetëror gjenocidial serb, u është pamundësuar e drejta për të dëshmuar për krimin, për të folur për krimin, sa nga stigantizimi, e sa nga mungesa e drejtësisë efektive. Ne e vlerësojmë lart faktin që këtë të premtë është neghëruar aktakuza e parë për dhunim gjatë luftës në Kosovë dhe është trajtuar si krim luftime.

Prandaj, nuk është e rastësishme që 20 vjet pas luftës, nga monumenti i pavarësisë jehoi kumbueshëm një zë - një thirrje, një mesazh, i cili u shndërrua në moto të betejës për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale. Mesazhi thoshte: "Plaga ime le të ketë zë!".

Ky mesazh e ky zë është zëri i ndërgjegjes sonë të munguar; është zëri i Vashfijes, i Shyhetes dhe i mijëra viktimave të tjera, të mbijetuarave dhe të më fortave ndër ne, ato duan të kenë zë, duan që plaga e tyre shpirtërore të shërohet duke ua njohur këtë plagë, në radhë të parë, dhe duke u siguruar drejtësi.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Është e dhimbshme që dy dekada pas luftës, tregimet e torturës dhe abuzimit seksual po mbahen të heshtura dhe jashtë metanarracionit të luftës dhe diskursit publik. Dhuna seksuale është ndër më çnjerëzoret, ngase, në njërin anë, e shpërfaq egërsinë e vrasësit dhe, në anën tjetër, i kërkon viktimës ta heshtë krimin. Por, heshtja e kimit nuk e zhbën atë asnjëherë. Përkundrazi, e bën dyfish më të rëndë. Të mos rrëfesh për krimin, të mos krijohen kushtet për ta rrëfyer atë, sepse mund të paragjykoresh, është njëjtë sikur ta mohosh atë; të mos ua njohësh statusin e vërtetë viktimave të dhunës është sikur të mos e pranosh viktimën e fatin e tmerrshëm të saj. Të mos e kërkosh me ngulm drejtësinë për këto viktima është sikur ta mohosh fatin e tyre.

Prandaj, ne kemi vendosur që seancën me të cilin do ta shënonim Ditën Ndërkombëtare të Gruas këtë vit t'ia kushtojmë zërit të mbytur të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, në mënyrë që atë zë ta shumëfishojmë, që të ndikojmë sadopak në ngritjen e vetëdijes për zërin e heshtur dhe për drejtësinë e munguar për viktimat e kësaj dhune. Duke u solidarizuar me këto të mbijetuara, ne sot i kujtojmë të gjitha viktimat dhe kërkojmë drejtësi për to. Duke folur me zërin tonë, së pari, dhe me ndërgjegjen e botës demokratike, së dyti, ne duam ta prekim në ndërgjegjen tonë dhe t'u bëjmë thirrje të gjitha të mbijetuarave, viktimave të dhunës seksuale,

por edhe familjarëve të tyre, që ta ngrenë zërin e tyre derisa statusi i të gjitha viktimave të njihet dhe për to të vendoset drejtësia. Prandaj, edhe një herë u bëj thirrje të gjitha të mbijetuarave që historinë e tyre t'ia besojnë Komisionit Shtetëror për Njohjen e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale në një proces që është i besueshëm dhe e ruan konfidencialitetin e plotë të viktimave.

Të nderuar deputetë,

Ne e dimë se nuk është aspak e lehtë të përballësh me paragjykimet, stigmatizimin dhe diskriminimin në përpjekjen e përditshme për të gjetur paqe dhe për të marrë drejtësi. Por, rrëfimi i krimit është më i fuqishëm se stigma, harresa dhe heshtja, sepse dhimbja e viktimave është dhimbja e shoqërisë, është dhembja e Kosovës. Plaga e heshtur e grave të dhunuara duhet të ndahet me Ne, që secili ta ndjejë dhe secili të luftojë njësoj për t'i përkrahur të mbijetuarat e dhunës.

Prandaj, duke e dëgjuar rrëfimin e tyre, nëpërmjet rrëfimit të Vasfijes, të cilën e kemi këtu, ne duam që sot t'i flasim vetes sonë, me zërin tonë, i cili ndoshta nuk do të dëgjohet përtej nesh, por i cili do ta ketë fuqinë të shpërthejë në klithmë për padrejtësinë që u bëhet të gjitha viktimave.

Ne këmbëngulim në këtë, sepse ne e dimë se dhimbja dhe humbja janë të mëdha, por nëse e shpërfaqim të keqen, ne e kemi njohur realitetin dhe kemi bërë një hap në kërkim të drejtësisë. Rrëfimi si i ky i sotmi në institucionin më të lartë përfaqësues në vend, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dëshmon për rëndësinë e zërave të grave në ndërtimin e narratives dhe të kujtesës së luftës.

Zëri i Vasfijes Krasniqi-Goodman, e cila guximshëm e nisi një mision të shenjtë, ngritjen e zërit kundër dhunës dhe kundër stigmës, duke iu adresuar edhe Kongresit Amerikan, Parlamentit të Suedisë, Senatit Italian, Koresë së Jugut, është zëri i mijëra viktimave që nuk kërkojnë asgjë tjetër, pos drejtësi, sepse ato gjithnjë e thanë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Prandaj, asaj edhe në Korenë e Jugut iu nda Çmimi për Paqe. Duke e ndarë historinë e saj me ne, ajo jo vetëm do ta kujtojë fatin e viktimave, por do të na ndihmojë që ta zgjojmë zërin e ndërgjegjes brenda nesh dhe të thërrasim fort për drejtësi.

Tetë Marsi filloi si lëvizje për të drejtat e grave për të votuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në djepin e demokracisë botërore dhe për kohëzotim edhe dhembja jonë shoqërore filloi të ngrejë zërin sensibilizues kundër këtyre veprimeve barbare, duke i dhënë shansin edhe Vasfijes dhe të gjithë neve që të fillojmë një mision të shenjtë, pra ngritjen e zërit kundër dhunës dhe kundër stigmës, pikërisht duke u adresuar nga Kongresi Amerikan. Beteja e Vasfijes nuk asnjëherë nuk ka qenë betejë individuale e saj. Ajo është betejë e saj për ta dëshmuar dhimbjen e një populli, dhimbjen e Kosovës.

Të dashur qytetarë,

Misioni ynë si kuvend nuk do të jetë i plotë nëse nuk angazhohemi që ta luftojmë stigmën në shoqëri. Si të zgjedhur të popullit, ne duhet ta ngremë zërin kundër paragjytimeve të tilla. Tek e fundit, barra e turpit gjithnjë do të bjerë mbi regjimin gjenocidal serb dhe asnjëherë mbi viktimat e pafajshme të dhunës seksuale.

Atyre që menduan se me krimin e tyre makabër do ta çnderonin një popull duhet t'ua themi me zë të lartë, sot e përherë: Vashija, Shyhretja dhe të mbijetuarat e tjera të kësaj dhune janë nderi ynë.

Prandaj, në emër të betejës për zë, më lejoni që ta ftoj zërin e viktimave, zërin e të mbijetuarave, zonzjen Vashije Krasniqi-Goodman që t'i drejtohet Parlamentit të Kosovës.

(Duartrokitje)

VASHIJE KRASNIQI-GOODMAN: E nderuar kryetare e Kuvendit të Kosovës, zonja Vjosa Osmani,

I nderuar kryeministër i Kosovës, zoti Albin Kurti,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë e deputete të Kuvendit të Kosovës,

E nderuar Familje Jashari,

Të nderuara familje të personave të zhdukur,

Ju veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ju invalidë të luftës, po ashtu të gjitha familje që lufta e Kosovës ju dëmtoi në mënyra të ndryshme,

Të nderuar ambasadorë, diplomatë, mysafirë të tjerë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Është nder dhe emocion i jashtëzakonshëm për mua që të jem sot këtu, në institucionin më të lartë të Kosovës. Dua të ju falënderoj për zemërsisht që kjo seancë e veçantë i kushtohet një çështjeje kaq të ndjeshme dhe po aq të rëndësishme për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës. Dhe, në këtë rast, më lejoni që në mënyrën më të veçantë t'i përsënder të gjitha viktimat e dhunës seksuale në Kosovë.

Ligji i Kosovës neve na quan viktimat, por ne jemi të mbijetuara. Tashmë ju e dini se kam pasur raste të flas në vende të ndryshme të botës, duke e treguar të vërtetën tonë, po asnjëherë nuk jam ndier siç ndihem sot këtu në Kosovë. Ndihem mirë kur e di që ka familjarë që i mbrojnë anëtarët e veta, kur e di që ka burra që i mbrojnë gratë e veta për atë se çfarë u ka ndodhur, por ndihem shumë keq kur e di që familjarët nuk i mbrojnë, nuk i përkrahin. U thonë fjalë që unë këtu nuk mund t'i përmend, ato fjalë me të cilat ballafaqohen ato, për hir të kësaj foltoreje, se duhet ditur se çka po thuhet këtu, ku jam unë tash. Edhe pse prej kësaj foltoreje kanë dalë fjalë që neve viktimave na kanë lënduar shumë. *(Duartrokitje)*

Vendi ynë, shoqëria jonë neve na stigmatizon, na bën që ne të mos ndihemi si vajza të mira, si motra të mira, si gra të mira, por edhe si nëna të mira. Po ku ishit ju atëherë para 21 vjetëve, a ishit në tavane kur iu dhunua gruaja nëpër dhoma, e ku e morët ju guximin ta lini atë grua me fëmijë, ta braktisni? Ku ishin djemtë që e panë nënën duke iu dhunuar, dhe e përzunë nënën, por e mbajtën gruan në shtëpi, e nuk e dinin që edhe gruan e kishin të dhunuar.

Ku ishit ju kur u dhuna Jeta 7-vjeçare? E, tash, ju, çka po bëni për të na e lehtësuar neve jetën? Duhet të ju vijë turp të gjithëve, gjithë shoqërisë kosovare, se neve po na viktimizoni për çdo ditë. Ne nuk duam kurrgjë tjetër prej shtetit, përveçse drejtësi. Prej familjarëve tonë ne duam mbrojtje, të na përkrahin e të na mbështetin, se çfarë na ka ndodhur neve ka qenë krim i luftës dhe ju nuk ishit aty që të na mbronin.

Ne kemi dëgjuar shumë shpesh, e kanë thënë që Vassija e ka shumë lehtë, sepse e ka burrin amerikan, vërtet unë e kam burrin amerikan dhe jam krenare që e kam burrin amerikan, ndihem shumë mirë, sepse ai më përkrah mua në misionin që unë kam ndërmarrë për të luftuar për të drejtat e Kosovës për atë çfarë na është bërë.

Por, mos harroni se vëllai im është këtu, e ballafaqohet me fjalime, me dyshime se çfarë thonë njerëzit, dhe ai po mundohet për çdo ditë që unë ta kem një jetë më të mirë, që edhe vajzat tjera, nënat dhe gratë tjera, ta kenë një jetë më të mirë, që ai i quan të gjitha motra.

(Duartrokitje)

Ne jemi duke e bërë një punë që shumica prej juve nuk jeni në gjendje ta bëni për nënën tuaj, vajzën tuaj, gruan tuaj e motrën tuaj, por si keni ju fytyrë kur ta dini që gruaja e juaj apo vajza e juaj ndihet më mirë e më lirë të shkojë te një shoqatë të flasë e të ballafaqohet me jetën e përditshme se çfarë i ka ndodhur asaj, sesa ta ketë mbështetjen te ti?

Kjo është e tmerrshme për krejt shoqërinë e Kosovës, e sidomos për burrat që i dëmtojnë gratë sot e atë ditë me rrahje, me mundime, veç për atë çfarë i bëri armiku gjatë luftës. Duhet të ndryshoni se ka ardhur fundi më, plot 20 vjet ne mjaft ju kemi duruar. Më nuk ju durojmë dhe nuk jua falim atë çka na keni detyruar ta përjetojmë për 20 vjet.

Për fund, unë i lus të gjithë deputetë, institucionet e Kosovës, që krimet e luftës t'i marrin me seriozitet, edhe dënimet t'i marrin me seriozitet, se mjaft më për plot 20 vjet të mos dënohet asnjë për rastet e dhunimit. Ju e dini që unë rastin e kam humbur, ma ka humbur UNMIK-u, pa ka humbur EULEX-i, por edhe shteti im nuk ka bërë asgjë hiç kur është puna për drejtësi. Absolutisht, në rastin tim nuk ka bërë asgjë fare. Unë nuk do të ndalem, do të luftoj që të tjerat të kenë mundësi që të kenë drejtësi, ajo që më është mohuar mua, prandaj ato nuk do t'i lë vetëm,

se unë e di çka është të luftosh për drejtësi, e të mos kesh askënd që ta jep një ndihmë a një këshillë, prandaj ne nuk mundëm vetëm që ta kemi atë drejtësi.

Kështu, ju kisha lutur që këto raste t'i merrni me zemërgjerësi që të fitojmë drejtësi. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARJA: E falënderoj zonjën Vasfije Krasniqi-Goodman që sot para Parlamentit të Kosovës edhe një herë u bë zëri i të gjitha të mbijetuarave të dhunës gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Tani e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës që t'i adresohet Kuvendit në emër të Qeverisë së Kosovës dhe pastaj do t'i ftoj edhe grupet parlamentare.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Turpi nuk u përket atyre që u përdhunuan, por të gjithë të tjerëve, të gjithë neve të tjerëve.

Shumë e respektuara, znj. Vasfije Krasniqi Goodman, mirë se erdhe në shtëpinë tënde!
E nderuar kryetare e Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani,
E nderuar nënkryetare, znj. Arbërie Nagavci,
Të nderuara deputete e deputetë të Kuvendit,
Të nderuar ministra, e zëvendëskryeministra,
Shkëlqesi ambasadorë dhe mysafirë të nderuar,
Të nderuar qytetarë të Republikës,
22 vjet kanë kaluar. Unë dje mora pjesë në dy marshe publike për të drejtat e grave, në Ditën Ndërkombëtare të tyre, më 8 Mars, dhe bëmë homazhe në Kompleksin Memorial "Heroinat".

Sot jemi këtu në Kuvendin e Republikës për të folur për një çështje që është, sa e dhimbshme, po aq edhe tragjike.

22 vjet kanë kaluar dhe plagët e luftës ende janë të hapura. Plagët i kemi të hapura në shumë fronte. Kemi ende persona të zhdukur, dëme që akoma s'i kemi matur, dhe shumë borxhe të papaguara. Por, fronti që na ka hapur plagë më tepër e për të cilin dua të kem vëmendjen tuaj sot, janë gratë dhe burrat e përdhunuar, të cilët edhe sot vazhdojnë të jetojnë me barrën e rëndë të padrejtësisë, stigmës dhe izolimit.

Ne nuk mund as t'i imagjinojmë dhimbjet dhe tmerrin që të mbijetuarat e dhunës seksuale të luftës kanë përjetuar, por edhe vuajtjet e vazhdueshme pas luftës, duke jetuar të heshtur, të izoluar e të harruar.

Si qytetar e si aktivist, dhe si deputet i Kuvendit të Republikës, e kam pasur për detyrë të flas e të kërkoj veprim shtetëror. Sot, si kryeministër i vendit tonë e kam për detyrë të veproj.

Kriminelët e luftës duhet të dënohen për krimet e shkaktuara në të gjitha frontet.

Deri sot ka pasur mungesë të qartë të angazhimit politik për ndjekjen penale të krimeve dhe kriminelëve të luftës dhe kjo vonesë kaq e madhe është po ashtu një pengesë e madhe. Mungesa nuk ka qëndruar vetëm në ndjekjen penale të tyre, por për shumë vjet edhe në vetë njohjen e tyre si viktima të luftës.

Me kalimin e shumë viteve, dëshmitarët vdesin dhe po ashtu edhe kriminelët, duke e bërë të pamundur gjykimin dhe sjelljen e tyre para drejtësisë. Por, asgjë nuk na ndalon që t'i gjykojmë ata në mungesë.

Heshtja dhe mosveprimi e mbron krimin dhe ekzekutuesin e krimit. Gjykatat dhe prokuroritë tona duhet t'i trajtojnë me seriozitetin maksimal rastet e dhunës seksuale në Kosovë. Legjislatura e kaluar e Kuvendit ka miratuar ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale që lejon gjykimin në mungesë për krime lufte, çka do të thotë se institucionet e Kosovës kanë të drejtë t'i nisnin hetimet edhe nëse i dyshuari nuk është i pranishëm në seancë gjatë gjykimi.

Qeveria është e gatshme të plotësojë çdo kërkesë të Prokurorisë për t'i rritur kapacitetet e nevojshme në këtë drejtim. Jemi më se të vetëdijshëm për ndarjen e qartë të pushteteve, dhe do ta respektojmë deri në pikën e fundit pavarësinë e Gjyqësorit, por, në anën tjetër, dëshiroj ta bëj të qartë se do të ofrojmë krejt ndihmën që na kërkohet.

Në Kosovë, edhe 22 vjet pas luftës, nuk kemi akoma as edhe një aktgjykim përfundimtar fajësues në lidhje me rastet e përdhunimi në kohë lufte. Asnjë! Kemi vendime të shkallës së parë, të cilat janë kthyer mbrapsht në shkallët e Apelit. Kjo, përkundër faktit që kemi gra e burra që kanë folur, kush publikisht, e kush veç në Prokurori.

E kemi zonjën Marte Tunaj, e cila ishte e para grua që në vitin 2013 dëshmoi hapur për përdhunimin që kishte përjetuar, dhe e cila vdiq në maj të vitit 2016 me një pension prej 96 eurosh. E kemi zonjën Vafije Krasniqi-Goodman, e cila e ka vazhduar misionin e shenjtë të Marte Tunajt, duke folur në vazhdimësi hapur për këtë çështje që e lëndon gjithë kombin tonë, dhe, së fundmi, e kemi edhe zonjën Shyhrete Tahiri-Sylejmani, e cila po ashtu ka treguar forcë të pashembullt kur ka vendosur të flasë për eksperiencën e saj.

Unë sot i falënderohem guximit të këtyre grave që frymëzojnë, dhe i inkurajoj edhe gratë e burrat e tjerë që ta kërkojnë drejtësinë e munguar.

Siç e dini, më 5 shkurt 2018 e ka filluar punën Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Deri tani, ky komision ka pranuar 1 226 aplikacione, prej të cilave në 785 rasteve u është njohur statusi, 236 u është refuzuar dhe 223 raste janë në rishqyrtim.

Unë dua ta shfrytëzoj këtë rast për t'u bërë thirrje personave të përdhunuar që të aplikojnë për njohjen e statusit të tyre. Qeveria do ta trajtojë me përgjegjësi dhe seriozitet çdo kërkesë të komisionit për ta kryer punën efektivisht dhe do t'u ofrojmë mbështetjen e nevojshme organeve të ndjekjes për dënimin e kriminelëve.

Procesi i njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar është një proces shumë delikat, por tejet i rëndësishëm për të ardhmen e viktimave dhe familjeve të tyre, por edhe për gjithë shoqërinë, prandaj unë pres që çdo pengesë për realizimin e mandatit të këtij komisioni të evidentohet dhe të adresohet te Qeveria sa më parë. Ky proces ka nisur me vonesë të jashtëzakonshme, por është më mirë që ka nisur tash, sesa të mos kishte nisur fare.

Unë nuk mund ta zhbëj të kaluarën, e as të kthej kohën prapa për ta adresuar në kohë këtë çështje, që do duhej të ishte adresuar me kohë. Po të ishte e mundur do ta bëja, por unë mund tash në emër të Qeverisë së re të them se ne bashkëndiejmë me vuajtjet dhe tragjedinë tuaj dhe unë nuk jam i qetë derisa ju ta gjeni qetësinë dhe drejtësinë që meritoni.

Përdhunimet gjatë luftës janë krime më të tmerrshme që kanë ndodhur, por ato asnjëherë nuk u trajtuan në bisedimet me Serbinë. Ne do të sigurohemi që kjo të ndryshojë, sepse nuk mund të arrijmë paqe pa e pranuar të kaluarën.

Kërkimfalja nga Serbia, reparacionet dhe qasja në drejtësi do të jenë pjesë e dialogut.

Një ndër prioritetet e Qeverisë sonë është padia e Kosovës për gjenocid kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo do të jetë rrugë e gjatë, sepse dëshirojmë që të sigurohemi që të jemi të suksesshëm në këtë proces, por ne veçse e kemi filluar punën në këtë drejtim. Pa ndëshkimin e krimeve të luftës nuk mund të kemi qetësi.

Krimet e luftës, gjenocidi e krimet kundër njerëzimit nuk janë të kaluara derisa dikush nuk merr përgjegjësi për to.

Faleminderit Vasfije! Ju faleminderit të gjithëve!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Sadriu.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti kryeministër! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje e ftoj deputeten Saranda Bogujevci që ta marrë fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Përshëndetje, e dashur Vasfije!

I nderuar Nafi,

E nderuar Kadire, Feride, Veprora, Mirëlinda,

Të nderuar anëtarë të Komisionit qeveritar për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit,

E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Osmani,

E nderuar nënkryetare e Kuvendit, zonja Nagavci,

I nderuar kryeministër Kurti,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të komuniteteve ndërkombëtare,

Kolege e kolegë deputetë,

Media,

Të dashur qytetarë,

Sot këtu ju drejtohem në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe tema për të cilën jemi mbledhur ta adresojmë për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas është një temë shumë e ndjeshme dhe e rëndë. Sot, në Kuvend po flasim për dhunimet që janë bërë nga forcat serbe ndaj shqiptarëve, por çka dallon nga herët e tjera është që sot këtu kemi vetë të mbijetuarën, Vasfijen. Njohja e vuajtjeve të vajzave, grave, burrave e djemve, të cilët ishin të dhunuar brutalisht gjatë luftës së fundit në Kosovë nga forcat serbe ka qenë një betejë e gjatë.

Gjatë rrugëtimit nga përfundimi i luftës për këto kategori u bëmë edhe ne si institucion njëfarë armiku i tyre. Kjo për arsye se nuk u bëmë zëri i tyre për tërë këto vite. Falë shoqatave të grave, shoqërisë civile dhe iniciativës së Lëvizjes Vetëvendosje për plotësim-ndryshim të ligjit, nga 2012 kjo temë u hap, dhe sot kjo kategori e dalë nga lufta arrin ta ketë njëfarë forme të barazisë me kategoritë e tjera, edhe pse jo të plotë. Po, është e vërtetë që jemi shembull si vend për ligjin që kemi tani në fuqi dhe për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, por kemi ende shumë punë për të bërë.

Për të përkrahur komisionin që ta kryejë punën e tij ashtu siç duhet, për të përkrahur organizatat që kanë punuar me këto gra tash e 20 vjet, dhe më e rëndësishmja në qendër të vëmendjes ta kemi ndihmën dhe përkrahjen ndaj të mbijetuarave dhe të mbijetuarve. Dalja publike e Vasfijes, përveç që ishte e guximshme, ka qenë një moment shumë i rëndësishëm për vendin tonë. Jo vetëm se po adresohet kjo çështje publikisht me emër dhe mbiemër, por gjithashtu filluan të dalin në pah mospërkrahja dhe mospuna rreth drejtësisë ndaj këtyre të mbijetuarave dhe familjeve të

tyre. Mospërkrahja për nevojat e tyre elementare, qoftë për shëndetin e tyre apo edhe mbijetesën e përditshmërisë.

Çështja e drejtësisë është kyçe për të mbijetuarat, drejtësia ka disa aspekte që shkojnë përmes gjykimeve, krijimit të mekanizmave, ku të mbijetuarit kanë përkrahje institucionale në aspektin shëndetësor, shoqëror, financiar dhe moral. Njohja e vuajtjeve të tyre është drejtësi. Sa i përket ndjekjes penale kisha dashur t'u referohem disa të dhënave, njëra ndër to është edhe Rezoluta 2467 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e 23 prillit 2019, për të ndaluar dhunën seksuale në konflikt. Kisha dashur t'i ndaj disa pjesë nga kjo rezolutë që ndërlidhen direkt me kërkesat e të mbijetuarve dhe nevojat e tyre.

Por, gjithashtu edhe sa është e rëndësishme që në shoqërinë tonë të fuqizojmë gruan. Njëra nga gjërat që del nga kjo rezolutë është që në çdo mekanizëm duhet të njihet nevoja për një qasje, ku në qendër është i mbijetuari dhe e mbijetuara, siç quhet në gjuhën angleze, “survivor center approach”. Pjesa tjetër që dua ta citoj që mendoj që është shumë me rëndësi që ndërlidhet me fuqizimin e gruas, thuhet: “Duke njohur rëndësinë e 20-vjetorit të Rezolutës 1325, progresin e bërë, si dhe mundësinë dhe nevojën për një zbatim shumë më të madh të agjendës së grave, po aq edhe të sigurisë, duke mbetur thellësisht të shqetësuar nga nënpërfaqësimi i shpeshtë i grave në shumë procese zyrtare e organe që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, numri relativisht i ulët të grave në pozita të larta në institucione politike, po aq edhe në institucione kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të lidhura me siguri. Mungesën e përgjigjeve adekuate humanitare të ndjeshme ndaj gjinive dhe mbështetje për rolet udhëheqëse të grave në këto ambiente. Financim të pamjaftueshëm për gratë, paqen dhe sigurinë dhe ndikimin e ndjeshëm që rezulton në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Kjo tregon për rëndësinë e numrit më të madh të grave në vendimmarrje, sidomos kur kemi të bëjmë me tema shumë të brishta dhe të ndjeshme, siç po e adresojmë sot. Ndër të tjera, kjo rezolutë gjithashtu adreson rëndësinë e gjykimeve për këto krime dhe çfarë duhet të ndërmerret nga shteti, i cili i kryen këtë krim. Pra, po citoj disa pjesë të kësaj rezolute: “Inkurajohen autoritetet shtetërore në këtë kontekst për të forcuar legjislacionin, për të nxitur përgjegjësinë për dhunën seksuale.

-Thekson rolin kritik të hetimit të brendshëm dhe sistemet gjyqësore të shteteve anëtare për të parandaluar dhe eliminuar dhunën seksuale në konflikt dhe për të siguruar përgjegjshmërinë nga ata që janë përgjegjës për këtë krim dhe kërkon entitete relevante të Kombeve të Bashkuara, përfshirë ekipin e ekspertëve për siguri, ligjin dhe dhunën seksuale të krijuar në bazë të Rezolutës 1888 për të mbështetur autoritetet kombëtare në përpjekjen e tyre në këtë drejtim. Ndër tjera, duke krijuar përgjegjësitë e shteteve për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për krimet e gjenocidit, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës të kryera kundër civilëve, në këtë drejtim duke vërejtur shumë shqetësime se

vetëm një numër shumë i kufizuar i autorëve të dhunës seksuale janë sjellë para drejtësisë, ndërsa në konflikt dhe luftë, dhe në situata pas konfliktit njihet se sisteme të drejtësisë shtetërore mund të dobësohen ndjeshëm.

Ndër të tjera, në një shkrim në BBC, ku shtrohet pyetja se si dhunimet u bënë armë e luftës, në bazë të një raporti nga Amnesty International thuhet se përdhunimi dhe abuzimi seksual nuk janë vetëm një nënprodukt i luftës, por përdoren si një strategji e qëllimshme ushtarake. Gjithashtu, përdhunimi oportunist dhe plaçkitja e shekujve të mëparshme është zëvendësuar në konflikt modern, ku përdhunimet përdoren si një mjet luftarak i orkestruar. Gjithashtu, me ju dua të ndaj disa të dhëna që kanë dalë nga Fondi për të Drejtën Humanitare. Sipas këtyre të dhënave statistikore nga Fondi, në Kosovë nga fundi i vitit 1999 deri më 2018 kanë qenë 48 lëndë në total që janë gjykuar për krimet e luftës, 19 për shqiptarë, 25 për serbë dhe etnitë e tjera. 61 të akuzuar janë shqiptarë, ndërsa 44 janë serbë, kurse të dënuar janë 34 shqiptarë dhe 4 serbë, dhe 24 serbë në arrati. Kjo tregon më së miri rëndësinë e ligjit që kemi në mungesë tani. Në të njëjtën kohë, tregon se sa pak është bërë sa i përket dënimit të kriminelëve të luftës, e në rastin e dhunimeve nuk kemi asnjë të dënuar.

Për ta përfunduar, kam një kërkesë, që ka ardhur në Kuvend nga mandati i kaluar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, që data 14 prill, dita kur është dhunuar Vafije Krasniqi, të jetë datë që i kujtojmë të gjitha viktimat e dhunës seksuale nga lufta e fundit në Kosovë. Propozimi ynë është që kjo të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit dhe në një kohë sa më të afërt të vijë edhe në Kuvend të Kosovës për t'u diskutuar dhe votuar. Gjithashtu, në bazë të dhënave muaji prill është njëri ndër muajt, ku më së shumti ka pasur dhunime. Sot këtu para jush kam shumë besim se kërkesa dhe nevojat e adresuara nga vetë viktimat dhe të mbijetuarat, siç tha Vafija, tani do të adresohen me dinjitet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ftoj zonjën Lirije Kajtazi që ta marrë fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetare!

E dashur Vafije,

E nderuar familje Krasniqi që duhet të jesh shembull për të gjitha familje të tjera mbështetëse e të mbijetuarave,

Ju zonja Gudmon, si misionare e drejtësisë, jo veç për veten, jo veç për të mbijetuarat tjera, por dhe për Kosovën dhe drejtësinë në botë,

E nderuar kryeparlamentare,

Qeveri,

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ambasadorë, që keni qenë afër kësaj kategorie të vendeve mike,

Zonjat lart atje që kanë folur edhe kur të tjetër kanë heshtur,
Të gjithë ju të respektuar qytetarë të dashur,
Sot kur bota shënon ose bën bilanci të shumë arritjeve dhe shënon përvjetorë të disa deklaratave që ka nxjerrë edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, edhe ne këtu në betejën për drejtësi përpiqemi të bëjmë maksimumin për një botë më të drejtë dhe më humane.

25 vjet të Deklaratës së Pekinit, për të çuar më tej objektivat e zhvillimit dhe të barazisë dhe të paqes për njerëzimin, në këtë vend ku edhe ne si Kosovë patëm marrë pjesë, 25 vjet të kësaj deklarate, 20 vjet të Rezolutës Gratë, paqja dhe siguria, Rezolutës 1325, e cila u bën thirrje të gjitha palëve në konflikt që të marrin masa të posaçme për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna në baza gjinore, veçanërisht përdhunimet dhe format e tjera të abuzimit. Del që kjo betejë nuk është e lehtë, beteja për drejtësi e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës '98-'99 po del të jetë nga më të vështirat, edhe pse kanë kaluar më shumë se dy dekada, viktimat e shumta që përjetuan dhunë ende nuk po gjejnë paqe, ngase ende asnjë nga kryesit e këtyre krimeve dhe urdhërdhënësit e tyre nuk kanë dalë para drejtësisë.

Masiviteti i akteve të dhunimit të bëra nga forcat policore dhe ushtarake serbe dëshmon se kjo formë e dhunës ka qenë e planifikuar dhe zbulon haptazi qëllimin e shtetit serb për shfarosje të shqiptarëve në këto hapësira, dëshmon vazhdimësinë e aplikimit të projekteve të shumta shfarosëse. Se qëllimi ka qenë shfarosja, dëshmon edhe sjellja e tanishme e shtetit serb, i cili nuk kërkon falje, nuk shkëputet nga ajo kohë e dhunës dhe dëshmi të shumta të faktuara, siç është krim edhe mbajtja e mbetjeve mortore si provë e mbulimit të të gjitha këtyre akteve dhe të të pagjeturve. Se dhunimi ka qenë pjesë e taktikës së shtetit serb për shfarosje konstaton një raport i vitit 2000 i organizatës për të drejtat e njeriut Human Rights, në të cilin thuhet: "Dhunimi është përdorur si taktikë lufte", atë që e tha edhe kolegja nga Vetëvendosje, "...është përdorur si taktikë lufte për t'i poshtëruar, frikësuar dhe zhvendosur me forcë civilët e një komuniteti të veçantë etnik dhe si mjet për ta ndryshuar demografinë e një territori", pra me një pasojë afatgjate për të ndryshuar demografinë për hesape politike.

Mizori të tilla në funksion të boshatisjes së Kosovës nga shqiptarët, duke përdorur policinë dhe ushtrinë tejkaloan çdo gjë njerëzore, por edhe shkelën ligjet në fuqi të vetë shtetit serb dhe ish-jugosllav atëherë, si dhe të gjitha konventat ndërkombëtare që kodifikojnë sjelljen e palëve në konflikt në rast lufte.

Ne sot jemi dëshmitarë të një rrëfimi autentik të zonjës Vasvije, e cila është vetëm njëra nga ato që po zhvillon një betejë të pakompromis për drejtësi, jo vetëm për veten, jo vetëm për të gjitha të mbijetuarat, por për Kosovën, për drejtësi në botë. Dëmi është i madh, ngase nga ky rrëfim, por edhe nga rrëfimet e tjera, nuk është e vështirë të konstatohet se dhunimet kanë qenë sistematike e të organizuara. Janë bërë me qëllim të ndikimit të thellë të destabilizimit të

komunitetit dhe popullatës në tërësi me pasoja afatgjate, duke atakuar moshat thuajse ekstreme: fëmijën 7 vjeç që e përmendi zonja Krasniqi dhe pastaj çdo moshë tjetër.

Ky rrëfim që ne dëgjuam sot nuk duhet të merret si pjesë e një fjale, e një propagande, por duhet të merret si një kuptim i drejtësisë, si një detyrë për ofrimin e ndihmës adekuate për ata që i mbijetuan këtij tmerri. Ky rrëfim që dëgjuam sot është një nga faktet që dëshmon shkeljen e Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, cenimi i integritetit fizik dhe mental të anëtarëve të grupit nacional, etnik, racor apo religjioz, i cili përbën akt gjenocidi.

Edhe pa dëshminë e zonjës Vasfije, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka bërë të ditur se në Ballkan, Kosovë, Kroaci e Bosnjë janë dhunuar seksualisht 60 000 femra. Ajo kërkon nga vendet anëtare që përdoruesit e dhunës apo shkatarrët e saj t'i ndjekim penalisht dhe të gjitha viktimat të kenë mbrojtje dhe drejtësi për to. Këtë e kërkojmë edhe ne, këtë e kërkon Vasfija në çdo vend, këtë e kërkojnë edhe të gjitha të mbijetuarat e dhunës, që nuk janë të pakta.

Ne si institucione kemi obligime të shumanshme sa i përket kësaj kategorie. Nuk mjafton vetëm ligji e as konventat që vijnë nga lart, nuk mjaftojnë edhe përkrahjet simbolike. Ne duhet të kemi një qasje të gjithanshme dhe një kujdes të shumanshëm institucional. Si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në vazhdimësi të kujdesit të kësaj kategorie, nga se edhe librin e parë për ta thyer heshtjen si dëshmi e krimeve dhe përdhunimeve del nga një autore që i përket Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Naxhije, me plot respektin që është këtu prezent, ka thyer heshtjen në atë kohë, duke u munduar që në forma të ndryshme të jetë afër tyre.

Ne përpiqemi që në disa pika ta shprehim kujdesin të përmbledhur që fusha e betejës edhe në veten tonë, për të kaluar pastaj në institucione, Vasfija e ka tejkaluar këtë, por duhet të krijojmë ambient të përshtatshëm që ato të pranohen në shoqëri si çdo derivat i luftës. Nëse kemi pasur respektin dhe kujdesin për të gjithë ato që ka derivuar lufta, për veteranët, për shkatërrimet ekonomike, për shumë gjëra të tjera, duhet të kemi esencialisht vëmendjen te kjo çështje, te kjo kategori. Investime serioze të shtetit në rehabilitimin psiko-social, duke përfshirë trajtimin shëndetësor, lehtësime në punësim, përkrahje të bizneseve. Ju e patë edhe në hyrje që është një pjesë e mirë e bizneseve, që ndihmon që të bëhet një vetëpunësim i kësaj kategorie në mënyrë që t'u mbijetohet sfidave të jetës.

Pra, luftimi i stigmës është jashtëzakonisht esencial, u tha edhe nga parafolësit, në mënyrë që ato ta gjejnë përkrahjen dhe fuqinë për të vazhduar tutje. Inkurajojmë viktimat të paraqiten te Komisioni Qeveritar. Gjatë raportimit të vet, Komisioni Qeveritar ka treguar për shumë mangësi që atyre u shfaqen në mungesë të përkrahjes adekuate dhe ne mendojmë se një përkrahje e komisionit do të inkurajojë edhe ato që të kenë besim, që të paraqiten te komisioni për të bërë verifikim të statusit.

Në bisedimet e ardhshme me Serbinë njëra nga temat kryesore, më erdhi mirë që e tha edhe kryeministri, të jetë vënia para drejtësisë urdhërdhënësve dhe kryerësve të akteve të dhunës së tillë. Në bisedimet e ardhshme, përpos reparacioneve të dëmit ekonomik, të futet domosdoshmërisht edhe reparacioni për viktimat e dhunës seksuale. Dhe, një luftë që u jep fund të gjitha luftërave është ajo që ende s'e njeh mendësia e Serbisë, është kërkim-falja. Kjo do ta distancojë atë nga e gjithë dhuna dhe do ta linte prapa atje.

Krejt në fund, edhe si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dëshirojmë t'i falënderojmë shumë shtete mike që u gjetën në kohëra të ndryshme pranë kësaj kategorie dhe që po ndihmojnë zërin e tyre kudo në botë Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ftoj deputeten Valdete Idrizi.

VALDETE IDRIZI: E nderuar Vassije!

Feride!

E nderuar kryetare e Kuvendit,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Media,

Ambasadorë,

Aktiviste dhe aktivistë që po ju shoh atje mbrapa,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot është 9 marsi, edhe sot është një ditë e mirë për të punuar për barazi. Jo vetëm më 8 Mars.

Për fuqizimin e gruas, për të drejtat e tyre e për drejtësinë e munguar për to. Janë 365 ditë në vit që duhet të punojmë për gruan, për viktimat e çfarëdolloj të dhunës, për drejtësinë që atyre u mungon, për ata që ende janë të zhdukur. Duhet të punojmë të gjithë. Duhet të punojmë çdo ditë, derisa krimet që Serbia i bëri në Kosovë të zbardhen.

E sot, në këtë seancë të veçantë që po u kushtohet viktimave të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës, grave dhe burrave, sepse kemi pasur edhe burra, ani pse fokusi sot është te gratë. Secila grua ka histori të çmuar sakrifice, rezistence, besimi i shprese. Shumë prej këtyre historive, histori lavdie e krenarie, i kemi dëgjuar, dhe jemi krenuar të gjithë. Sapo përfundoi edhe Epopeja e UÇK-së. U krenuam të gjithë me ato histori të atyre grave tona. Por, ka edhe shumë histori të trishta që akoma nuk janë dëgjuar, histori sikur kjo e Vassijes, si historia e Shyhretes, si historia e shumë grave të tjera që akoma nuk janë dëgjuar, akoma mbeten të heshtura, sepse ne si shoqëri nuk u kemi krijuar hapësirën dhe besimin e nevojshëm për t'u rrëfyer, e rrjedhimisht për të dokumentuar krimin e tmerrshëm që kanë përjetuar ato. Dhe, pasojat e atij krimi që i vuajtën dhe vazhdojnë t'i vuajnë ato dhe familjarët e tyre.

Ani pse kanë kaluar njëzet vjet nga përfundimi i luftës, këto gra dhe burra, shumica prej tyre akoma janë të heshtur. Akoma nuk e kanë gjetur guximin që të rrëfejnë ngjarjet e tyre. Sepse ne si shoqëri kemi heshtur. E kemi quajtur histori turpi, histori që në vend se të rëndonte ata që e kanë kryer krimin, ajo i rëndonte ata mbi të cilët është kryer krimi. Ani pse kemi fituar betejën për të thyer tabunë, tabunë e krimit të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, akoma kemi shumë për të bërë për ta luftuar stigmën, siç e tha edhe Vassija, që ende ekziston në shoqërinë tonë, për të mbijetuarit e këtij krijimi çnjerëzor të luftës.

Fushata ‘Dëgjo zërin tim’ ka marrë jehonë në gjithë botën. Ne kemi dëshmuar se mund të ndryshojmë gjërat nëse duhen, edhe nëse të gjithë bëhemi bashkë. Ende duhet të luftojmë mendësinë që fajin e kanë viktimat e këtij krimi. Duhet të luftojmë paragjykimet që shoqërojnë të mbijetuarat. Duhet të luftojmë çdo ditë. Nder na bën të gjithëve pikë së pari si qytetar, si shoqëri, si shtet kur mbështesim të mbijetuarit. Nuk na bën nder kur i paragjykojmë ato apo familjarët e tyre. Nuk duhet harruar asnjëherë se secili prej nesh kemi mundur të jemi në vend të tyre. Këtë shpesh njerëzit po e harrojnë.

Shteti i Serbisë, shtet përgjegjës për këto krime, asnjëherë nuk i ka pranuar mizoritë që ushtroi mbi popullatën civile, mbi vajzat e djemtë, gratë e burrat. Ende as nuk ka kërkuar falje, ndërsa drejtësia ende po mungon.

U tha edhe më herët, të gjithë e dimë se dhuna seksuale gjatë luftës ka qenë taktikë e luftës për të nxitur spastrimin etnik, për të nxitur dëbimin e shqiptarëve nga shtëpitë e tyre, për të nxitur ndarjen në mes nesh, edhe pas përfundimit të luftës. Ne nuk duhet të lejojmë që ky krim mizor të shkatërrojë edhe më tej familjet tona. Nuk duhet të lejojmë që të mbijetuarat të ndihen të vetme. Ne duhet t’u qëndrojmë në krah. T’u garantojmë të gjitha të drejtat dhe të luftojmë për drejtësinë e munguar.

Ju kemi borxh, Vassije! Ty dhe gjithë të tjerave dhe gjithë të tjerëve.

Mirënjohje, respekt, për të gjitha përpjekjet e bëra deri më sot në përkrahje të këtyre grave dhe burrave. Organizatat e shoqërisë civile që u kanë ofruar ndihmën psiko-sociale, siç janë organizatat e udhëhequra nga Feridja, nga Veprorja, nga Linda, Kadirja, nga e ndjera Sevdije Ahmeti, nga Flora Brovina. Pastaj në avokim për të drejtat e tyre Rrjeti i Grave të Kosovës, Gratë artiste, të cilat e shfrytëzuan si platformë artin për të ndërgjegjësuar shoqërinë tonë për këtë krim të tmerrshëm. Pastaj edhe organizatat që u përmendën më herët që kanë punuar me vite për dokumentimin e këtyre krimeve. Mirënjohje e respekt për të gjitha!

Pas të gjitha këtyre përpjekjeve, pas një rrugëtimi të vështirë, Komisioni qeveritar për verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës filloi punën tash dy vjet, me profesionistë dhe njerëz të përkushtuar, duke e ditur se është një proces jashtëzakonisht i

ndjeshëm. Ne të gjithë duhet të sigurohemi që ky institucion shtetëror të vazhdojë të ketë përkrahjen e nevojshme. Të plotësohen edhe më tej kërkesat për mbështetjen e nevojshme profesionale teknike, të sigurohet buxheti për këtë komision, në mënyrë që të mos mbetet vetëm në gatishmëri për të mbështetur, por të ndërmerren të gjithë hapat që duhet që vërtet të mbështet këtë proces shtetëror. Andaj, edhe në emër tim dhe në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, e ftoj edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës që të sigurojë të gjithë këta hapa, fillimisht edhe buxhetin për këtë komision. Sepse nuk kemi kohë për të humbur, nuk kemi asnjë ditë më për të humbur. Nuk kemi kohë për të humbur, sepse u thanë shifrat, me të vërtetë janë, të mos them edhe frikësuese, të atyre që po hezitojnë të aplikojnë për të marrë këtë pension.

Edhe ne në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, për të Zhdukurit dhe Peticionet, ku unë jam anëtare, e kam ngritur këtë shqetësim. Prandaj, sot pasdite, si komision do të vizitojmë komisionin, do t'i dëgjojmë edhe një herë kërkesat, në mënyrë që edhe ne si deputetë, si komision ta kryejmë punën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ne duhet ta bëjmë këtë, sepse duhet inkurajuar e ftuar të mbijetuarat të aplikojnë për statusin e personit të dhunuar gjatë luftës. Andaj, edhe prej këtu ju bëj një ftesë, mos hezitoni, të dashura gra, dhe burra, ju që keni qenë viktimë e këtij krimi! Ju ftoj që të merrni kurajën si Vassija, si Shyhretja, si dhe të tjerat! Të aplikoni, të dokumentoni këtë krim, sepse është e drejtë juaja. E ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës do t'ju mbështesim juve dhe Komisionin qeveritar për njohjen e statusit dhe vuajtjes suaj. Do të kërkojmë sqarime dhe llogari për të gjitha pengesat eventuale nëse dalin dhe do të kërkojmë mbështetje për të gjitha kërkesat e nevojshme. Ky proces është konfidencial. Të dhënat tuaja do të ruhen, konfidencialiteti është i garantuar me ligj dhe ne do të sigurohemi që respektimi i këtij ligji të vazhdojë. Duhet ta vëmë prioritet tonin që të thyhen paragjykimet dhe stigma. Dhe t'u themi grave dhe burrave të mbijetuar lirisht të aplikojnë. Thjesht, ta rrisin besimin në këto institucione.

Ne edhe vitin e kaluar, mu këtu në Kuvend me nismën e kryetarit të atëhershëm, ish-kryetarit z. Veseli, është mbajtur një seancë ku kemi folur për krime, ku kemi folur edhe për nismën e tij për themelimin e Tribunalit për krime lufte, ku edhe u formua një komision. Pavarësisht a jemi pozitë a opozitë, ne duhet të jemi të gjithë bashkë që të vazhdojë ky proces.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju familjarë të të mbijetuarve, shoqëri e Kosovës, mbështetni të mbijetuarat, mos i paragjykoni ato. E pamë, rasti më i mirë është rasti i Vassijes, kur familja e mbështeste prej fillimit, dhe me atë mbështetje e kemi parë sa e fuqishme është Vassija, edhe gjithandej nëpër botë dëshmoi për këto krime dhe vazhdon të jetë një zë i fuqishëm dhe një ambasadore. Faleminderit Vassije!

Duhet ta përsëritim shpesh se dhuna seksuale është krim. Duhet ta themi pa ndalur derisa të ketë drejtësi për këta të mbijetuar. Derisa kriminelët të dënohen dhe viktimat të realizojnë të drejtën e

tyre për reparacion. Nuk do të lejojmë asnjëherë që ky proces i njohjeve dhe verifikimit të dëmtohet. Do të bëjmë çdo gjë që procesi të jetë i dinjitetshëm, ashtu si kanë nevojë dhe respekt këto viktime ose këta të mbijetuar.

Dhe, për fund, dua ta përmbyll me një rrëfim personal. Kjo është një engjëll mbrojtës, është një grua, e cila është me ne, na përcjell tash, e cila është afër 20 vjet që e njoh, më fton të pimë kafe. Ulemi të pimë kafe. Unë pres që ka ndonjë kërkesë, edhe e nxjerr prej çantës një dhuratë, këtë zinxhir, këtë engjëll, edhe thotë e kam një lajm të mirë, se e kam fituar pensionin. Edhe gjëja e parë që tha unë kam blerë me të, është ky engjëll. Jam emocionuar edhe atëherë, edhe sot po emocionohem. I thashë nuk mund të pranoj, unë shumë pak kam bërë për ty, ose aspak, po ndihem e vogël para teje. Ajo tha jo nuk është e vërtetë, falë grave si ti, edhe grave të tjera, unë jam këtu sot më e fuqishme për t'i inkurajuar edhe ato të tjerat. Faleminderit, mikja ime! Faleminderit!

Edhe, për fund. Po, Vasfije, e pate një lutje, duhet ta marrim shumë seriozisht krimin, edhe luftën tonë për drejtësi. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa u ballafaquar ashtu si duhet me të kaluarën. Faleminderit shumë!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ftoj deputeten Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: E nderuar Vasfije!

E nderuar Feride,

E nderuar kryetare e Kuvendit,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ambasadorë,

E nderuara secila nga ju që ishit mbështetja më e madhe rreth kësaj stigme, të këtyre paragjykimeve që po na mundojnë edhe sot e kësaj dite.

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Çmimi i lirisë së Kosovës, të cilin e paguam si popull, vërtet ishte i lartë. Krahas shkatërrimeve marramendëse gjithandej, vuajtjeve, torturave, vrasjeve në përmasa të gjenocidit në Kosovë, ndodhën edhe aktet më çnjerëzore të mundshme, siç ishte dhuna e shfrenuar serbe ndaj çdo gjëje shqiptare. Përdhunimet seksuale gjatë viteve '98/'99 paraqesin anën më të errët jo vetëm të një regjimi siç ishte ai serb, por edhe fytyrën e vërtetë të një populli të shfrenuar, për fat të keq. Këto akte makabre lanë plagë të mëdha në vendin tonë.

Femra në Kosovë gjatë kësaj periudhe, mjerisht u bë pjesë e pa ndarë e këtyre akteve çnjerëzore, e kësaj tragjedie të papërshkruar që e përjetoi mbi kurriz e në shpirt Kosova. Duke qenë pjesë e pandarë e kësaj tragjedie kolektive, gruaja shqiptare, në fakt, përbën plagën e dhimbjen tonë të

përvetshme për vetë çmimin që padrejtësisht e pagoi në mënyrën më antinjerëzore. A ka padrejtësi më të madhe e akt a vepër më të shëmtuar se sa krimi e përdhunimi i shtyllës së familjes së njerëzimit.

Të nderuar,

Vërtet nuk ka mënyrë e fjalë që do të përshkruanin në thelb mizorinë e shkaktuar nga regjimi serb ndaj të mbijetuarave, të mbijetuarve, e cila gjatë kësaj kohe u bë shënjestër kryesore e luftës së egër me gjithë përmasat e kësaj barbarie. Sidomos për ato që u bënë viktimë e drejtpërdrejtë, e natyrisht edhe plagë e përvetshme e shoqërisë sonë. Historia e gjithë kësaj tragjedie kolektive duket se fundin e ka shumë larg, sepse trajtimi i saj kërkon punë, angazhim dhe përkushtim njerëzor, në radhë të parë, në mënyrë që së paku të kryejmë një pjesë të përgjegjësisë që rëndon dhe shfaqet para nesh.

Ne jemi të obliguar, madje konsideroj që edhe është detyrë e jona parësore që në çdo kohë të jemi të gatshëm që përballë kërkesave që kanë të bëjmë me rehabilitimin dhe trajtimin e tyre, të jemi të kujdesshëm për vetë ndjeshmërinë e këtyre rasteve, raste të cilat na prekin të gjithëve pa dallim, sidomos institucionet tona shtetërore.

Niveli i përgjegjësisë duhet të rritet gjithnjë e më shumë, sepse kjo kategori, edhe pas më shumë se dy dekadave nuk duhet të shihet përsëri si viktimë e nënçmuar dhe e përbuzur padrejtësisht. Ne duhet të luftojmë e të punojmë shumë për lirinë e tyre shpirtërore, çlirimin emocional dhe, në fund trajtimin njerëzor e të dinjitetshëm institucional, për të cilin aq shumë kanë nevojë. Institucionet tona duhet të bëjnë edhe më shumë, duke filluar nga puna e komisioneve parlamentare e qeveritare, në funksion të një trajtimi me zgjidhje sa më optimale për vetë faktin e peshës, mbi të gjitha në familjen tonë si shtyllë kryesore, pra që është vetë gruaja.

Ndaj ne, jo vetëm që duhet të kërkojmë drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, por që njëkohësisht të veprojmë për ofrimin e mundësive më të mira për to, në mënyrë që nga fati i tyre tragjik të marrim të gjithë nga pak. Trajtimi i rasteve të tilla, madje një nga një, është detyrë e institucioneve që ne duhet ta përkrahim në çdo moment, pa kursyet asgjë. Sepse tashmë, kur thyerja e tabusë mbi këtë dukuri ka ndodhur, detyra jonë primare mbetet veprimi. Veprimi njerëzor, shoqëror dhe institucional. Ne duhet që krahas angazhimit tonë, ta rrisim vetëdijen tonë qytetare, edhe në kuptimin që të fitojnë të gjitha të mbijetuarat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale, që lirshëm të aplikojnë në institucionet përkatëse, duke bashkëpunuar ngushtë për lehtësimin e barrës që rëndon mbi ta dhe zgjidhjen më të pranueshme, jo vetëm për motrat, nënat, por të gjithë ata që përjetuan dhunë.

Për përfundimin e obligimit tonë, ky është pra më se obligim yni institucional dhe qytetar. Për herë të parë në mandatin e kaluar, pra Qeveria e Kosovës ndau një buxhet për të mbijetuarit e

dhunës seksuale gjatë luftës, një buxhet të konsideruar, pra në vitin 2017, ku me këtë buxhet u vu në funksion Komisioni për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale.

Sot kur po diskutojmë, ndodhemi në prag të marrëveshjes finale me Serbinë. E ende aktorët përgjegjës për kryerjen e këtyre krimeve nuk janë dënuar. Madje as kriminelët që janë të njohur me emër dhe mbiemër. Përderisa Kosovës iu imponua padrejtësisht formimi i Gjykatës Speciale, një gjykatë e padrejtë, njëetnike, edhe sot e kësaj dite Serbia nuk ndalet, ngase çdo ditë pra shfrytëzon çdo mekanizëm, ku ajo edhe sot mban një qytetar që ishte bashkatdhetar yni, pra Nezir Mehmetajn e mban në burg, edhe pse ai nuk ishte as në Kosovë në kohën e luftës.

Përtej deklaratave dhe debateve që janë të mirëseardhura, po nuk mjaftojnë, shteti duhet të veprojë që kriminelët të ndëshkohen. Nuk ka paqe pa drejtësi.

Vasfije,

Në emër të grupit tonë parlamentar, faleminderit që ishe zëri ynë, faleminderit që ishe zëri i së vërtetës! Të lumtë për kurajën! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate, Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Znj. Vasfije, pa ju dridhur zëri dhe pa ju trembur qerpiku, do të vish këtu në Kuvend, sa herë që ju e shihni të nevojshme që të flasësh, sepse ne të gjithë veç e veç, e besa edhe të gjithë së bashku jemi shumë me të vegjël sesa ju, dhe zëri ynë është shumë më i pafuqishëm se sa zëri juaj.

E dashur znj. Vasfije,

E nderuar kryetare e Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Ju kolegë deputetë,

Nga një protestë, nga një kërkim të të drejtës së votës, nga një kërkim për barazi gjinore, nga një kërkim për mosdiskriminim në punë, nga një kërkim, mbi të gjitha mbi të drejtën e edukimit, 8 Marsi u shndërruar gradualisht në një festë, dhe kushdo që thotë se nuk është festë, mendoj se e ka gabim, për shkak se nga një zero kur ishin gratë në të kaluarën, tanimë jemi në një tetë pothuajse në mbarë botën. Nuk ka më mirë se sa të shohësh këto ditë mijëra burra në botë duke i falënderuar gratë, nënat e vajzat e tyre për gjithçka, e t'u dhurojnë lule, duke simbolizuar shumë dashuri për to.

Por, në fakt, ne sot jemi mbledhur këtu që të flasim për një temë, e cila nuk krahasohet me asnjë nga ato më lart. Është shumë më e rëndë, është shumë më tragjike dhe është shumë më e

dhimbshme. Sfidat e asaj kohe, në ditët e sotme kanë dallime të mëdha në sfidat me të cilat përballëshin para 22 vjetësh Vasfija dhe mijëra gra të tjera si ajo. Vasfija dhe mijëra vajza dhe gra të tjera u ballafaquan me mizorinë e dhunimit nga forcat kriminale të shtetit të Serbisë gjatë luftës në Kosovës.

Ne në moshën e saj kemi menduar se cilat nga atletet janë më në trend për t'i blerë, ndërsa Vasfija dhe vajzat e asaj kohe kanë kryer shkollim me një palë këpucë nga ato të zezat që nuk i donte askush, po që ishin të detyruara t'i mbathnin.

Sot ato janë heroinat tona. Sot ato e kanë motivuar gjeneratën time dhe do ta motivojnë gjeneratën e ardhshme që të edukohemi e të jetojmë të lumtura me gjithçka që kemi.

Njoh shumë burra e gra që e kanë ndërprerë shkollimin e tyre, duke mos pasur se çfarë të veshin e mbathin, ne sot zgjedhim modelet, fal atyre që dje luftuan. Prandaj, Vasfija, Shyhretja e mijëra gra të dhunuara janë heroinat tona. Këto heroina na i kanë hapur rrugët neve, që sot të jemi në një liri, e që këtë liri nuk do ta ndërrojmë me asgjë në botë. E di se shumë burra rrinë kokulur kudo kur flitet për këtë temë. E di se ata ndjehen keq që nuk ishin në gjendje t'i ndihmojnë secilës. E di që iu dhemb zemra aq shumë, secilit burrë, sepse gratë mbështetjen dhe sigurinë më të madhe e kanë nga burrat. Prandaj, kokulur, ata mendojnë shpeshherë se edhe ata e kanë një pjesë të fajit, por jo, faji nuk është te ata, por te pushtuesi i egër, i cili dhunimin seksual e kishte shndërruar në armë, në funksion të shkatërrimit të femrës shqiptare, në pikën tonë më të fortë.

Edhe sikur të gjithë burrat të rrinin në shtëpitë e tyre për t'i mbrojtur gratë nga sulmet e tilla, përballë një force të tillë që dhunimin e ka përdorur si armë, do të ishte e pamundur të mbroheshin të gjitha, sepse sikurse e thashë më lart, qëllimi i forcave serbe ishte shkatërrimi i femrës shqiptare. Ata mundur të rrinë me gratë e tyre, por kanë zgjedhur me luftën, sepse po ta zgjidhnin këtë të parën, vështirë se do të ishin këtu. Por, këtë nuk e kanë arritur, sepse gruaja shqiptare do të jetë me vlerat më të mëdha në botën demokratike si gjithherë. Gratë shqiptare, si Vasfija, do të jenë shembull i forcës e i vullnetit për liri e jetë. Gruaja shqiptare si Vasfija është guarr me moral më të lartë se vetë morali. Gratë shqiptare janë shembull i rezistencës, janë shembull i moralit, janë shembull i familjes. Gratë shqiptare janë gra e nëna të pamposhtura. Gjithmonë do të jemi krenarë, sa të jemi gjallë për ato dhe për ata që luftuan. Gjithmonë dhe në çdo moment, me ndjenjë dhembjeje për të gjitha gratë që u detyruan t'u nënshtrohen dhunimeve seksuale, veprim ky më çnjerëzor i mundshëm.

Ato përjetuan diçka, që vetëm po ta imagjinosh, të sjellë neveri dhe trishtim, e lëre më ta përjetosh. Fatkeqësisht, edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga përfundimi i luftës, drejtësia ende nuk është vënë në vend sa i përket këtij krimi makabër të forcave serbe. Shoqëria jonë, shteti i Kosovës, nuk duhet të ndalet asnjëherë së kërkuari drejtësi, derisa, jo vetëm ata që kryen krime

të tilla të vihen para drejtësisë, por edhe derisa shteti i Serbisë të dënohet për të gjitha krimet e kryera në Kosovë dhe në veçanti për krimin e dhunimit si krim gjenocidi.

Vasfije, faleminderit që ekziston, faleminderit që na bërë t'i hapim sytë e të kërkojmë të drejtën tonë mbi burrat, mbi shoqërinë tonë, mbi shtetin e mbi tërë botën demokratike. Faleminderit që ke ndarë me ne përjetimin tënd, e që ky përjetim i juaji nuk është përjetim i juaji, është përjetim i imi, është përjetimi i jonë, është përjetim i secilit veç e veç.

Znj. Vasfije, do të jesh arsyeja e jetës së shumë grave të tjera. E di se sot nuk është ditë të kritikohemi mes nesh, por kur u drejtohem Daçiqit e Daçiqëve me kriminelin Daçiq, të mos na shndërrojë këtë parashtesë pushteti në zotëri Daçiq. Ata që mbetën, ata mbetën dhe do të besim, gjithmonë, gjithherë, të njëjtë siç ishin. Pra, para se t'i themi nga kriminel në zotëri, të mendojmë znj. Vasfije. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, fjalën e ka deputetja Fidan Jilta.

FIDAN JILTA: Teşekkürler Sayın Başkan!

Sayın Meclis Başkanım, Başkan yardımcılarım, Başbakanım, Bakanlar, Büyükelçiler, Avrupa Birliği temsilcisi, Sivil toplum kuruluş temsilcileri, Basın mensubu arkadaşlar, Sayın Vasfiye hanım ve Savaş maduru kadınlar.

Öncelikle hepimizi saygıyla selamlıyorum. Haklarımız ile alındığında bilimsel verilere dayalı ve cinsellik eğitimine, hizmetine önem vermemizin önemi büyüktür. Ayrıca taciz, tecavüz ve şiddeten uzak yaşama hakkına sahip olduğumuzu biliyoruz. Bedenlerimizi ve hayatlarımızı etkileyen tüm politikalar, kanunlar ve programlar üzerinde sözümüzü söylemeye hakkımızın olduğunu da biliyoruz.

Kosova Cumhuriyetinde bu konuda bir an önce adaletin yerini bulmasını istiyoruz. Çünkü kadın hakları, insan haklarıdır. Kadına yönelik ayrımcılığa ve her tür şiddete hayır diyoruz. Kosovalı bir milletvekili olarak bütün vekillerle birlikte Kosova Savaşında madur durumda olan kadınların her daim yanlarında olduğumuzu bilmelerini istiyoruz. Bu kadınların tekrar toplumumuza kazanılması lazım. Sözlerimi bitirirken Sesim ol diyorum. Behu zeri im. Budi moj glas. Ovmoro avazo. Be my voice. Teiekkürler!

KRYETARJA: Faleminderit! Në fund, në emër të deputetëve pa grup parlamentar, e ftoj deputetin Veton Berisha.

VETON BERISHA: E nderuar kryetare, znj. Osmani,
I nderuar Kabinet qeveritar,
E nderuar znj. Vasfije Krasniqi-Goodman,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të gjithë ju të pranishëm,

Duke qenë i vetëdijshëm për ndjeshmërinë e çështjes për të cilën po flasim, rreth ngritjes së vetëdijes së shoqërisë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë do të mundohem që sadopak ta jap kontributin tim rreth kësaj teme, duke kërkuar vëmendjen e opinionit rreth ekspozesë time, e cila do të jetë vetëdijesuese.

Ndiej obligim dhe përgjegjësi që të dënoj ashpër secilin veprim të dhunimi të kryer gjatë luftës në Kosovë, por edhe në periudhën e hershme të pasluftës, sidomos ndaj grave të pambrojtura, e disa prej tyre edhe nga komunitetet pakicë në Kosovë. Më duhet ta potencoj se viktimat e dhunimit gjatë luftës së fundit në Kosovë nga ana e forcave serbe nuk ishin vetëm gratë shqiptare, por flas me përgjegjësi të plotë, se me dhjetëra viktima nga i njëjti agresor serb ishin edhe gra nga komuniteti im egjiptian, por edhe nga komunitetet e tjera.

Duke falënderuar gazetaren e çmuar, znj. Serbeze Haxhijaj nga BIRN, e cila me shumë guxim dhe kujdes në nëntor të vitit 2019 për herë të parë publikoi artikull të veçantë, ku personazh kryesor e kishte viktimën e dhunuar, e cila ishte e përkatësisë së komunitetit egjiptian, znj. Shehrie Balaj nga fshati Bllagajë, komuna e Pejës, e cila më datë 5 maj 1999 ishte marrë me dhunë në shtëpinë e saj nga katër policë të uniformuar dhe ishte dërgua në drejtim të panjohur. Ndërkaq, në mbrëmje ajo ishte kthyer e gjakosur, e rrahur, e dhunuar dhe më të nxira në gjithë trupin.

Personazhi për të cilin po flasim është kjo, e cila tani është e ndjerë.

Duke jetuar në afërsi të viktimës, bazuar në deklaratimet e saj dhe deklaratimet e familjarëve, ajo kishte përjetuar një tmerr të vërtetë, duke rezistuar për të mos dhënë informata për vendndodhjen e shumë personave të kërkuar të asaj kohe dhe të asaj rrethine, duke kërkuar vendndodhjen e shumë aktivistëve dhe kontribuuesve të luftës çlirimtare. Në vitin 2013 Shehrije Balaj ishte ndër dëshmitaret e para femër nga Kosova, e cila dëshmoi dy herë në Beograd se si u përdhunua, duke dhënë prova në gjyqin e ish-komandantit të ushtrisë jugosllave, Toplica Miladinoviq dhe dhjetë të tjerëve në Beograd për krime lufte të kryera në fshatrat Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Lubeniq afër qytetit të Pejës, ku të paktën 100 civilë u vranë në prill dhe në maj të vitit 1999.

Znj. Shehrije i identifikoi 3 prej tyre në gjykatë: Sreçko Popoviq, Boban Bogiçeviq dhe Dejan Bullatoviq, një grup luftëtarësh të njësisë ‘Çakallët’, të cilët u dënuan në Beograd më 2014 me gjithsej 106 vjet burgim, por Gjykata serbe e Apelit më pas e rrëzoi vendimin dhe kjo çështje tani është duke u rigjykuar.

Ndërkohë, znj. Shehrije Balaj vdiq në varfëri në shtator të vitit 2018, pasi vuajti për shumë vjet nga sëmundje të ndryshme. Në Kosovë asaj nuk iu dha asnjë ndihmë dhe as përkrahje

ekonomike. Dëshmia e saj për përdhunimin nuk tërhoqi ndonjë vëmendje nga institucionet e Kosovës dhe ajo kurrë nuk u fut në listat e ndonjërës prej OJQ-ve të Kosovës që ofrojnë ndihmë për viktimat e përdhunimit gjatë luftës.

A thua pse vallë ndodhi kështu, që e njëjta nuk e mori vëmendjen tonë? Nuk do të besoja se znj. Shehrije ishte zë i pafuqishëm vetëm se pse ishte një grua e varfër dhe kishte përkatësi etnike egjiptiane. Ajo gjithashtu nuk arriti të fitonte statusin e viktimës së dhunës seksuale, një skemë e Qeverisë së Kosovës, që u jep mundësinë të mbijetuarave të kërkojnë pension mujor prej rreth 230 eurosh, pasi ta kalojnë një proces verifikimi. Pra, asaj dhe familjes së saj asnjëherë nuk iu dha vëmendje institucionale në Kosovë, ku sot e asaj dite familja është në gjendje të rëndë ekonomike dhe emocionale.

Me përgjegjësi të plotë them se të njëjtin fat e kishin edhe shumë gra dhe vajza nga komuniteti im egjiptian, me atë të znj. Shehrije, por ja që znj. Shehrije e kishte guximin e znj. Vasfije për të folur hapur dhe për të kërkuar drejtësi për përdhunimin e tyre dhe të tjerave. Nga përvoja ime si anëtar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Personave të Pagjetur dhe Peticione në mandatin e kaluar dhe nga monitorimi i procesit të verifikimit nga ana e Komisionit për Verifikimin e Viktimave të Dhunës Seksuale është vërejtur se ai komision ka shumë probleme dhe pengesa në verifikimin e këtyre rasteve, aq më tepër nuk kam vërejtur se ka ndonjë proces motivues të lehtësuar për të identifikuar pa pengesa këto viktime. Duke e ditur thellë ndjeshmërinë e këtyre çështjeve, mendoj se është sfidë e vërtetë institucionale për t'u identifikuar të gjitha viktimat e dhunës seksuale.

Zonja dhe zotërinj,

E gjithë kjo përmbledhje imja në këtë fjalim ka të bërë për të theksuar në këtë fjalim ka të bëjë për të theksuar dhe tërhequr vëmendjen e të gjithë opinionit kosovar, krerëve të shtetit, se lufta në Kosovë nuk ishte luftë vetëm mes serbëve dhe shqiptarëve, por e vërteta ishte se lufta në Kosovë ishte mes shtetit okupues serb dhe të gjithë atyre që jetuan në Kosovë, përpos komunitetit serb. Këtë e bazoj edhe nga të dhënat tona që dëshmojnë se rreth 100 pjesëtarë të komunitetit egjiptian ishin aktivë në luftën çlirimtare të Kosovës. Kishim dëshmorë. Kemi me dhjetëra viktime civile, me mijëra familje të zhvendosura, qindra shtëpi të djegura, dhjetëra gra dhe vajza të dhunuara, mbështetje të plotë në të gjitha fondet e organizuar në mërgatë nga mërgimtarët tanë të komunitetit egjiptian.

Me këtë rast, po ashtu paraqes nevojën imediate të institucioneve të Kosovës që të identifikojnë të gjitha viktimat e dhunës seksuale, edhe ato të pas qershorit të vitit 1999, raste këto të ndodhura në mesin e grave nga komuniteti im, të cilat në muajt e parë të pasluftës ishin viktime të personave që kishin kryer akte të dhunës seksuale ndaj grave të pambrojtura, duke keqpërdorur edhe autoritetet e shpifura. Andaj, unë nga këtu e dënoj secilin rast të dhunimit në Kosovë, që ka ndodhur pavarësisht periudhës kohore.

Duke qenë përfaqësues i komunitetit egjiptian dhe duke besuar fuqishëm në institucionet e Kosovës dhe duke marrë përsipër monitorimin e drejtpërdrejt të secilit veprim institucional, nga këtu inkurajoj të gjitha gratë viktime, e në veçanti ato nga komuniteti im egjiptian, të përdhunuara gjatë luftës në Kosovë, të paraqiten para Komisionit verifikues, në mënyrë që paktën të jenë përfituese të beneficioneve që atyre ua ka ofruar ligji.

Gjithashtu, inkurajoj që të raportohen të gjitha rastet e izoluara të përdhunimeve. Nga këtu, e mbyll fjalimin tim, duke u thënë të gjitha viktimave të përdhunimit në Kosovë se jeni vlerë e shtuar e krenarisë sonë dhe asnjëherë e turpit, ashtu siç mendohet. Inkurajoj të gjithë familjarët vërtet të jenë në mbështetje tuajën. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që në emër tuajin edhe një herë ta falënderoj për zemërsisht znj. Vasfije Krasniqi-Goodman, që sërish dëshmoi që është zëri më i fuqishëm i të gjithë të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Kjo ishte seancë e veçantë e Kuvendit për sensibilizimin e kësaj çështjeje, kurse tani ju ftoj që të përcillni ekspozitën e shoqatave të grave, të cilat i mbështetin të mbijetuarat e dhunës seksuale.

Po ashtu, e falënderoj edhe znj. Rushiti dhe të gjitha shoqatat që na kanë ndihmuar që të bëhet ky organizim.

Ju ftoj të na bashkoheni në hollin e Kuvendit dhe ju falënderoj për pjesëmarrje, duke e mbyllur këtë seancë.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*